



## Programi i Vaksinimit në Shtëpi i Masaçusetsit

Komonuelthi po punon me Bordet lokale të Shëndetësisë dhe ka hartuar një program për të ofruar vaksinat në shtëpi për individët që nuk dalin dot nga shtëpia për të shkuar në qendrën ku bëhet vaksina.

### E drejta për Programin e Vaksinimit në Shtëpi të Masaçusetsit

**Vaksinimet në shtëpi janë për ata individë të cilët nuk janë në gjendje të dalin nga shtëpia për të shkuar në qendrën e vaksinave, edhe me ndihmë. Këta individë kanë nevojë ose:**

1. Për ambulancë ose për dy persona që ti ndihmojnë për të dalë nga shtëpia, ose
2. Nuk janë në gjendje të dalin nga shtëpia për takimet me mjekun në rrethana normale, ose
3. Kanë vështirësi dhe/ose kërkojnë ndihmë për të dalë nga shtëpia për takimet me mjekun.

### Si të lidheni me Programin e Vaksinimit në Shtëpi të Masaçusetsit

Organizatrat që mbështesin individët që nuk dalin nga shtëpia dhe që mund të kërkojnë të vaksinohen në shtëpi, mund të referohen nga Linja Marrëse Qendrore Shtetërore e Vaksinimit në Shtëpi, që operohet nga MassOptions, për tu kontrolluar në se është e përshtatshme të bëjnë vaksinën në shtëpi dhe të lidhen me burimet për të lënë orarin për vaksinën.

#### **Linja Marrëse Qendrore Shtetërore e Vaksinimit në Shtëpi**

**1-833-983-0485**

E hënë deri të premte

9:00 e mëngjesit deri në 5:00 pasdite

Linjën Marrëse Qendrore Shtetërore të Vaksinimit në Shtëpi e gjeni në anglisht dhe spanjisht. Përkthyesit do të jenë në dispozicion për të mbështetur banorët në rreth 100 gjuhë të tjera.

### Rreth Programit të Vaksinimit në Shtëpi të Masaçusetsit

Për njerëzit që nuk mund të dalin nga shtëpia për të bërë vaksinën, edhe me ndihmë, **Komonuelthi ka gjetur një zgjidhje me shumë drejtime për të siguruar që këta individë të kenë mundësinë e vaksinimit në shtëpi.**

**Shumë nga Bordet lokale të Shëndetësisë po menaxhojnë vetë programet e vaksinimit në shtëpi për komunitetin e tyre, ndërsa të tjerë kanë zgjedhur të partnerizohen me programin e vaksinimit në shtëpi nëpërmjet Aleancës së Kujdesit të Komonuelthit (Commonwealth Care Alliance) (CCA).**



**Kur një individ kontakton Linjën Marrëse Qendrore Shtetërore të Vaksinimit në Shtëpi, ai do të ketë mundësi të flasë me një përfaqësues, i cili do t'i bëjë pyetje për të vendosur në se vaksinimi në shtëpi është i përshtatshëm** (siç përcaktohet më sipër). Linja Marrëse Qendrore Shtetërore e Vaksinimit në Shtëpi ka mundësi të ndihmojë individët për t'i sqaruar në se kanë të drejtën për vaksinimin në shtëpi, por ajo nuk ka mundësi të lërë takimin për vaksinën, tu përgjigjet pyetjeve për COVID-19 ose të japë këshilla shëndetësore.

**Në se vaksinimi në shtëpi është i përshtatshëm, ata do të regjistrohen pranë Ofruesit Shtetëror të Vaksinimit në Shtëpi, Commonwealth Care Alliance, ose do të referohen te Bordi lokal i shëndetësisë ku banojnë dhe në se bordi lokal i shëndetësisë siguron vaksinimin në shtëpi.**

Në se vaksinimi në shtëpi nuk është i përshtatshëm, thirrësit do t'i sugjerohen burime të tjera për ndihmë për të lënë takimin në një qendër vaksinimi ose për të gjetur zgjidhje për transportin.

**Ofruesi Shtetëror i Vaksinave në Shtëpi, Commonwealth Care Alliance, do të merret me caktimin e orarit dhe administrimin e vaksinave në shtëpi.**

- Individët që janë regjistruar në Programin Shtetëror do të marrin një telefonatë nga Ofruesi Shtetëror i Vaksinave në Shtëpi për të caktuar orarin e vaksinimit në shtëpi brenda afërsisht tri ditë pune pas regjistrimit.
- Ofruesi Shtetëror i Vaksinave në Shtëpi ka staf mjekësor profesionist të cilët shkojnë në shtëpi për të administruar vaksinën e COVID-19 sipas të gjitha udhëzimeve shëndetësore publike. Gjatë procesit të lënies së orarit, vaksinuesi do të diskutojë nevojat individuale të personit që do t'i bëhet vakcina. Vaksinuesit janë profesionistë të mjekësisë të trajnuar të cilëve u është vërtetuar pastërtia e figurës, ndjekin të gjitha praktikatat më të mira të shëndetit publik, dhe kanë me vete të gjitha ilaçet kundër reaksioneve alergjike.
- Ofruesi Shtetëror i Vaksinave në Shtëpi do të përdorë vaksinën e miratuar nga FDA me një dozë të Johnson & Johnson's Janssen Vaccine.

**Për shkak të konsideratave për skadimin e vaksinës gjatë transportit, njerëzit që vaksinohen në shtëpi do të grupohen sipas ndarjes gjeografike, dhe jo në bazë të "kush është i pari shërbehet i pari". Për shkak të këtyre sfidave logjistike, një individ mund t'i duhen të presë disa javë për të bërë vaksinën.**

Për individët që kanë nevojë për regjistrimin paraprak ose për të lënë takimin në qendrën e vaksinimit, ju lutemi referojuni 2-1-1 (877-211-6277).